

20040691283

**L I G J I**  
**PËR GARANTIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR OBLIGIMET NGA**  
**MARRËVESHJA PËR HUA DHE FINANCIM, E DESTINUAR PËR SHPEJTIMIN E**  
**ZHVILLIMIT TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME NË REPUBLIKËN**  
**E MAQEDONISË, E CILA DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS SË MAQEDONISË**  
**PËR MBËSHTETJEN E ZHVILLIMIT DHE BANKËS KREDITORE PËR RINDËRTIM**  
**NGA RF E GJERMANISË**

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton përmbushjen e obligimeve sipas Marrëveshjes për hua dhe financim, të destinuar për shpejtimin e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë, e cila do të lidhet ndërmjet Bankës së Maqedonisë për Mbështetjen e Zhvillimit dhe Bankës Kreditore për Rindërtim nga RF e Gjermanisë, në shumë prej 6.184.804,12 euro, në afate dhe kushte të parapara në Marrëveshjen për hua dhe financim, vetëm në rastet kur BMMZH nuk do ta paguajë huanë.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huasë nga neni 1 i këtij ligji, do të përcaktohen me Marrëveshjen për hua dhe financim ndërmjet Bankës së Maqedonisë për Mbështetje të Zhvillimit dhe Bankës Kreditore për Rindërtim nga RF e Gjermanisë.

Neni 3

Të gjitha obligimet financiare të cilat rrjedhin nga Marrëveshja për hua dhe financim nga neni 1 i këtij ligji, si edhe servisimin e huasë, do ta bëjë Banka e Maqedonisë për Mbështetjen e Zhvillimit nga të hyrat, të cilat i realizon, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen për hua dhe financim.

Neni 4

Huaja nga Marrëveshja nga neni 1 i këtij ligji, do të paguhet me këste për 40 vjet, me 10 vjet grejs periudhë të përfshirë, në këste gjysmëvjetore në pajtim me planet për pagim.

Huaja përbëhet prej dy transhave, për të cilat do të paguhet shkallë interesi të ndryshme:

- transha e parë prej 1.071.885,31 euro, me shkallë kamate prej 0,75% në vjet, dhe
- transha e dytë prej 5.112.918,81 euro, me shkallë kamate prej 2,00% në vjet.

Për mjetet e patërhequra do të paguhet provizion për mjete të patërhequra prej 0,25% në vjet. Provizionin i mjeteve të patërhequra do të fillojë të paguhet 3 muaj pas nënshkrimit të Marrëveshjes për hua dhe financim.

Për anuitetet e arritura, por të papaguara, paguhet kamatë vonesë. Kamatëvonesa është në lartësi të “shkallës themelore”, të smadhuar për 3,00% në vjet. Shkallë themelore është shkalla e cila është shpallur nga ana e Bankës Qendrore të RF të Gjermanisë, në ditën e arritjes së anuitetit.

Për anuitetet e arritura e të papaguara, Banka Kreditore për Rindërtim nga RF e Gjermanisë mund të kërkojë dëmshpërblim. Dëmshpërblimi kalkulohet në shumën e kamatëvonesës, në lartësi maksimale të shkallës themelore të smadhuar për 3,00% në vjet.

Neni 5

Në qoftë se obligimet e arritura në bazë të kamatës dhe kryegjësë, në afatet e parapara me marrëveshjen për hua, në emër të Bankës Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit, i paguan Republika e Maqedonisë, Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit është e obliguar që

në afat prej 30 ditëve nga dita e kryerjes së obligimit, të transferojë në dobi të llogarisë së të hyrave të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, mjete në denarë në lartësi të pagimit të kryer, të smadhuara për kamatën e kalkuluar dhe për shpenzimet e krijuara që kanë të bëjnë me transaksionin përkatës.

#### Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.